



## VENDIM

*Nr.90 Datë 06.09.2013*

**PËR  
MODIFIKIMIN E LIÇENSËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “DN&NAT ENERGJI” SH.P.K ME  
NR.128, SERIA PV11P, LESHUAR ME VENDIM TE BORDIT TE  
KOMISIONEREVE TE ERE-S NR.58, DT. 22.06.2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa”b”, pika 3 pika 4, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Liçensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.09.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “MAKSI ELEKTRIK” sh.p.k për ndryshimin e liçensës Nr.128, Seria PV11P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.58, datë 22.06.2011 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

### **Konstatoi se:**

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “DN&NAT ENERGJI” sh.p.k plotëson kërkesat e “Rregullores së procedurave të liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, si më poshtë:

- ***Neni 15, pika 4, germa “a”:***

Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës. (është plotësuar tërësisht)

- ***Neni 15, pika 4, germa “b”:***

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim liçense. (është plotësuar tërësisht)

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Modifikimin e liçensës së shoqërisë “DN&NAT ENER GjI” me numër Nr.128, seri PV11P, për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Hec “KUMBULL MERKURTH” me fuqi 630 KW lëshuar me Vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.58, dt. 22.06.2011.
2. Fuqia e instaluar e Hec “KUMBULL MERKURTH” nga 630 KW të bëhet 830 KW.
3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari ne Detyre  
Shkelqim Bozgo**